



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.976/21

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbare të Kompania Rajonale Ujësjellësi “Prishtina” sh.a me adresë në rr. “Hazir Shala” nr. 4, Prishtinë, kundër debitorit F...H...- B.T. me adresë në rr. “...” Ll.a-..., Lipjan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr. 441/21 i datës 30.03.2021, të lejuar nga Përmbaresi Privat Bardh B. Tasholli me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 28.04.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË prapësimi i debitorit F...H...- B.T. me seli në Lipjan i paraqitur kundër Urdhrit Përmbare P.nr. 441/21 i datës 30.03.2021, të lejuar nga Përmbaresi Privat Bardh B. Tasholli me seli në Ferizaj si i PASAFATSHEM.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar Urdhrit Përmbare P.nr. 441/21 i datës 30.03.2021 duke lejuar përmbaremin në bazë të Ekstraktit nga librat afarist nr. K002599 për periudhën nga data 01.01.2013 deri më 24.03.2021 me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të shërbimeve për konsumin e ujit t’ia paguaj shumën prej 242.35 € (dyqind e katër dhjetë e dy euro e tridhjetë e pesë euro cent), si dhe shpenzimet e procedurës përmbare.

Debitori në prapësimin e paraqitur ka deklaruar se detyrimi që rrjedh nga dokumenti i besueshëm është përfshirë në parashkrim, kjo pasi që afati për të ushtruar procedurë përmbare mbi bazën e faturës parashkruhet brenda një (1) viti. Tutje ka shtuar se kreditori nuk e ftuar asnjëherë debitorin që të përmbush detyrimin e tij por vetëm është urdhëruar që ta paguaj borxhin e pretenduar menjëherë sipas dokumentit përmbare.

Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paraqitura nga ana e debitorit si në prapësim duke theksuar se debitori ka bërë pagesa të pjesshme të borxhit andaj në kuptim të nenit 368 të LMD-së i njëjti e ka ndërprerë parashkrimin përmes pohimit të borxhit. Ka shtuar se debitori ka pranuar faturat e kreditorit për çdo muaj dhe e ka pranuar shërbimin. Me kërkesë që Prapësimi të refuzohet ndërsa Urdhri Përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pasafatshëm për arsyet si në vijim:

Gjykata gjeti se debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr. 441/21 i datës 30.03.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Bardh B. Tasholli, e ka pranuar me datë 06.04.2021, fakt ky që vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal të përmbaruesit privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa debitori prapësimin e ka paraqitur përmes postës me nr. rekomande R 1537542, me datë 14.04.2021.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se: *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”* Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbarimor e ka pranuar me datë 06.04.2021, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 07.04.2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 13.04.2021.

Megenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 14.04.2021, e cila vërtetohet nga vula e pranimit të postës me nr. rekomande R 1537542, me datë 14.04.2021, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me një (1) ditë vonesë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.976/22, datë 28.04.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.